VENDIM
Nr.221, datë 20.12.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO EMANUEL"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat "Radio Emanuel", në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 14.1.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati